

ANALIZË E SHKURTË  
**Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar?**  
*Shtator 2013, Prizren dhe Gjilan*

## PËRMBAJTJA

I. Hyrje.....	2
II. Metodologjia e hulumtimit.....	3
III. Për projektin .....	3
IV. Të gjeturat kryesore të hulumtimit.....	4
V. Përfundimet.....	5
VI. Rekomandimet.....	7
EC Ma Ndryshe.....	8
KCIC.....	9
Shtojcë, Rezultatet me grafike për Prizren dhe Gjilan.....	10

*Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Rritja e Pjesëmarrjes përmes Mediave Sociale”, i përkrahur financiarisht nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Projekti SMILE i financuar nga Democratic Governance Thematic Trust Fund (DGTTF)*

## I. Hyrje

Ky raport shqyrton transparencën e komunave të Prizrenit dhe të Gjilanit në raport me të rinjtë që jetojnë në këto dy qendra urbane. Të gjeturat e këtij raporti burojnë nga hulumtimi respektivisht anketimi i të rinjve të shkollave të mesme dhe të universiteteve të Prizrenit dhe Gjilanit. Në anketa janë përfshirë nga 200 të rinj nga secila komunë, që i janë përgjigjur pyetjeve në lidhje me funksionimin e pushtetit lokal, transparencën dhe përfshirjen e publikut dhe të rinjve në vendimmarrjen komunale.

Rezultatet e hulumtimit në përgjithësi tregojnë se përfshirja e rinisë në vendimmarrjen e komunave të Prizrenit dhe të Gjilanit nuk është në nivel të lartë, se qeverisja është pak transparente, se rinia nuk është e informuar për buxhetimin me pjesëmarrje dhe se nuk ka konsulta të duhura me ta gjatë hartimit të dokumenteve të rëndësishme strategjike.

Anketat e kryera dëshmojnë se të rinjtë e dy komunave mbeten jashtë procesit të politikbërjes komunale derisa përfshirja e tyre në konsultimet publike është shumë e rrallë dhe kryesisht e natyrës formale për përmbushjen e obligimeve minimale ligjore. Në të njëjtën kohë njohuritë e këtyre të rinjve në lidhje me të drejtat e tyre qytetare janë në nivel të ultë dhe nevojitet një qasje e strukturuar e institucioneve vendimmarrëse dhe e atyre arsimore por edhe e shoqërisë civile për përmirësimin e këtyre trendeve.

Korniza ligjore mbi të cilën bazohet vendimmarrja komunale ofron mundësi për përfshirjen e publikut dhe në këtë rast të rinjve në proceset vendimmarrëse.

Për më shumë, Udhëzimi Administrativ 2008/09 i MAPL-së<sup>1</sup> përcakton se përveç takimeve publike komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik.

Ky udhëzim administrativ parasheh që në kuadër të Planit të veprimit për transparencë të përfshihen edhe iniciativa si: Raportimi më i shpeshtë në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale dhe çështje tjera. Për më tepër, rekomandohet mbajtja e konferencave periodike të shtypit (çdo dy javë ose çdo muaj) por edhe organizimi i seancave pyetje-përgjigje me publikun e gjerë ose grupet e interesit. Gjithashtu, kërkohet përditësimi i ueb-faqeve zyrtare të komunës.

Hulumtimi me të rinjtë e Prizrenit dhe të Gjilanit nxjerr në shesh defekte të ndryshme të zbatimit në praktikë të këtij akti nënligjor. EC Ma Ndryshe edhe në publikimet e mëparshme, duke trajtuar çështjen e "Transparencës së qeverisjes lokale në Prizren"<sup>2</sup> ka nënvizuar se transparenca paraqet parimin thelbësor të qeverisjes së mirë. Qasja e lirë në informata luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës. Informacioni, megjithatë, duhet të jepet në kohë, të jetë relevant, i saktë dhe i plotë për t'u përdorur në mënyrë efektive.

<sup>1</sup> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Udhëzim Administrativ për transparencë në komuna, në <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/0f8d2612-8259-43ad-828c-dda2cc3fc318/UA-Nr--2008-09-Per-transparenca-ne-Komuna.aspx>

<sup>2</sup> EC Ma Ndryshe, Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, në [http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC\\_Respektimi\\_i\\_ligjit\\_ne\\_qeverisjen\\_lokale.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_Respektimi_i_ligjit_ne_qeverisjen_lokale.pdf)

## II. Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi ka përfshirë anketimin e 200 të rinjve në komunën e Prizrenit dhe 200 të rinjve të tjerë në komunën e Gjilanit. Mostra është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, me anketimin e çdo të pestit. Hulumtimi është kryer në hapësirat shkollore e universitare përkatësisht në oborret e tyre dhe në rrugë. 100 anketa janë kryer në katër shkolla të mesme, nga 25 në secilën, 50 në universitet publik e privat apo nga 25 në secilën dhe 50 të tjera në rrugë. Në komunën e Prizrenit mëse 98.5% të respondentëve ishin të nacionalitetit shqiptar, 1% të nacionalitetit romë dhe 0.5% të nacionalitetit turk. Ndërsa në komunën e Gjilanit të gjithë respondentët ishin të nacionaliteti shqiptar. Sa i përket moshës, në komunën e Prizrenit mëse 65% të respondentëve ishin të moshës 16-20 vjeçar, 23.5% të moshës 21-25 vjeçar, rreth 9% të moshës 26-30 vjeçar dhe 2.5% të moshës 31-35 vjeçar. Ndërsa në komunën e Gjilanit, 58% të respondentëve ishin 16-20 vjeçar, 30.5% të moshës 21 – 25 vjeçar, 10% të moshës 26 – 30 vjeçar dhe 1% të moshës 31 – 35 vjeçar. Margjina e gabimit është rreth dy përqind (+ ose -).

Të rinjtë janë pyetur për funksionimin e pushtetit lokal, transparencën dhe përfshirjen e publikut dhe të rinjve në vendimmarrjen komunale.

## III. Për projektin

Projekti “Rritja e pjesëmarrjes përmes medieve sociale” i mbështetur financiarisht nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) është duke u zbatuar nga EC Ma Ndryshe në Prizren dhe në partneritet me KCIC-në në Gjilan.

Hulumtimi me të rinjtë e Prizrenit dhe Gjilanit është kryer për nevojat e këtij projekti.

Qëllimi i projektit është që të inkurajoj të rinjtë e Prizrenit dhe të Gjilanit për pjesëmarrje në vendimmarrje lokale dhe që përmes qasjes inovative dhe edukative t’ju lehtësoj atyre kuptimin e të drejtave qytetare dhe përgjegjësi. Për më tepër, projekti synon të ngushtojë hendekun mes pushtetit lokal dhe të rinjve duke i mbështetur ata përmes aktiviteteve të ndryshme në terren dhe në komunitet, duke përdorur mjetet sociale që janë në dispozicion gjithnjë e më shumë.

Projekti i ka tre objektiva kryesore: i) Forcimin e komunikimit interaktiv dhe të drejtpërdrejtë midis pushtetit lokal dhe grupeve rinore; ii) Të rrënjosë një kuptim më të mirë nga të rinjtë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre qytetare duke zhvilluar dhe futur në përdorim mediat sociale, dhe iii) Të rris interesimin e publikut dhe kuptimin e të drejtave qytetare dhe përgjegjësi.

Për realizimin e këtyre objektivave po monitorohet puna e qeverisë komunale dhe do të avokohet për çështjet që janë preokupim i të rinjve. Gjithashtu do të organizohen takime mes rinisë dhe zyrtarëve komunal.

Është krijuar Ueb Portali, i dedikuar për këtë projekt, ku shpalosen të gjitha të gjeturat e monitorimit. Brenda ueb portalit janë krijuar Platformat Online, si: Buxheti me pjesëmarrje; Platforma për shprehjen e shqetësimeve, dhe Peticioni elektronik.<sup>3</sup>

Projekti ka krijuar edhe sms platformën përmes së cilës publiku informohet mbi vendimet dhe takimet publike të Komunës së Prizrenit.

<sup>3</sup> Ky portal gjendet në linkun <http://online-transparency.org/rpms/>

Projekti do të ndihmojë të rinjtë në veçanti dhe qytetarët në përgjithësi në adresimin e shqetësimeve të tyre tek organet vendimmarrëse përmes përdorimit të mediave sociale, që do të thotë se edhe qeveria lokale do të përfitojë, pasi që do të ketë një komunikim interaktiv me qytetarin. Qindra të rinj do të jenë të angazhuar në mënyrë aktive në projekt përmes aplikimeve online, si dhe përmes anketave.

Ky është një projekt i qytetarisë dhe i dedikohet kryesisht rinisë në komunën e Prizrenit dhe Gjilanit, femrave dhe meshkujve të të gjitha grupeve etnike. Me pjesëmarrjen në këtë projekt të rinjtë dhe qytetarët do të përfitojnë në mënyrë të tillë që do të ndihen të fuqizuar dhe do të shërbejnë si agjentë për ndryshime sociale.

#### **IV. Të gjeturat kryesore të hulumtimit në Prizren dhe Gjilan**

Rezultatet e hulumtimit në përgjithësi tregojnë se përfshirja e rinisë në vendimmarrjen e komunave të Prizrenit dhe të Gjilanit nuk është në nivel të lartë, se qeverisja është pak transparente, se rinia nuk është e informuar për buxhetimin me pjesëmarrje dhe se nuk ka konsulta të duhura me ta gjatë hartimit të dokumenteve të rëndësishme strategjike.

Anketat e bëra tregojnë se njohuritë e këtyre të rinjve në lidhje me të drejtat e tyre qytetare mbeten në nivel të ultë. Përderisa 61 për qind e të rinjve të anketuar të Prizrenit nuk kanë njohuri për vendimmarrjen në komunë, në Gjilan trendi tregohet të jetë paksa më pozitiv, ngase 55 për qind e të rinjve nuk kanë njohuri të tillë. Mbi 43 për qind të rinjve të Gjilanit e

dinë mënyrën e funksionimit të komunës përballë 38 përqindëshit të Prizrenit.

Si sfiduese paraqitet të jetë edhe transparenca e këtyre komunave karshi qytetarëve respektiv. Më shumë se gjysma e të rinjve të Prizrenit besojnë se qeveria lokale ka pak transparencë në punën e saj derisa 38 për qind thonë se transparenca është në nivel mesatar. Për dallim prej Prizrenit, transparenca në komunën e Gjilanit sipas të rinjve është në nivel më të kënaqshëm ngase 46 për qind të tyre besojnë se qeveria komunale është mesatarisht transparente, në krahasim me 45 për qind të tyre që thonë se ka pak transparencë.

Të rinjtë në përgjithësi janë lënë apo kanë mbetur jashtë proceseve të politikbërjes komunale. Vetëm një në mesin e shtatë të rinjve prizrenas kanë marrë ndonjëherë pjesë në mbledhjet publike të Kuvendit Komunal. Rezultat i njëjtë është shfaqur edhe në Gjilan, ku 83 për qind të respondentëve janë përgjigjur se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në seancat e KK-së.

Edhe përfshirja e moshave të reja në konsultimet publike është shumë e rrallë. Vetëm një në mesin e pesë të rinjve të Prizrenit ka marrë pjesë në debatet publike të organizuara nga komuna. Në Gjilan, hulumtimi ka treguar një trend tjetër ngase në këtë komunë dy në mesin e pesë të rinjve kanë marrë pjesë në diskutime publike.

Ndërkohë zëri i rinisë pothuajse nuk është dëgjuar fare gjatë hartimit të buxheteve komunale, si në Prizren ashtu edhe në Gjilan. Pjesa dërmuese e tyre nuk kanë qenë të informuar për procesin. Në Prizren 87 për qind e të rinjve të anketuar nuk kanë qenë të informuar për procesin e hartimit të buxhetit,

derisa në Gjilan janë 82 për qind e të rinjve që nuk kanë informata për hartimin e buxhetit.

Për dallim nga buxheti, situatë paksa më e mirë pasqyrohet në konsultimin gjatë hartimit të dokumenteve strategjike. Në Prizren pak më shumë se gjysma e të anketuarve kanë deklaruar se nuk janë konsultuar fare, derisa pjesa e mbetur kanë përmendur debatet publike dhe ueb faqen e komunës si mënyrë të përfshirjes. Anketimi në Gjilan ka treguar rezultate më inkurajuese edhe në këtë çështje. Pak më shumë se një e treta e të rinjve të anketuar kanë thënë se nuk janë konsultuar nga komuna gjatë hartimit të dokumenteve strategjike derisa një e treta tjetër ka deklaruar të jetë përfshirë me debate publike. Ndërsa 23.5 për qind e të anketuarve në Gjilan kanë pohuar të jenë kyçur në proces në saje të ueb faqes së komunës.

Ndërkohë edhe përfaqësuesit e ekzekutivit komunal janë treguar të mbyllur në komunikimin me rininë, në lidhje me shqetësimet e këtij grupi të shoqërisë. Në mesin e 10 të rinjve prizrenas vetëm njëri prej tyre ka pas rastin që të paraqes problemet para kryetarit apo drejtorëve të komunës. Ndërsa në mesin e 10 të rinjve gjilanas po ashtu vetëm njëri prej tyre ka pas rastin që të paraqes problemet para kryetarit apo drejtorëve të komunës, mirëpo me dallimin se në mesin e 10 tyre një tjetër ka refuzuar që të përgjigjet në këtë pyetje.

Mungesa e kontakteve me përfaqësuesit e ekzekutivit, si duket ka dobësuar edhe më tej ndjenjën e aktivizmit tek të rinjtë e të dy komunave. Vetëm një në mesin e dhjetë të rinjve të Prizrenit ka provuar personalisht apo në grup me qytetarët tjerë që të inicioj ndonjë nismë për zgjidhjen e ndonjë problemi, derisa tetë të tjerë as që kanë menduar për një gjë të

tillë. Ndërsa në Gjilan gati tre të rinj në mesin e dhjetë vetëve kanë pasur iniciativa individuale apo grupe për zgjidhjen e problemeve.

Sa i përket mjeteve që të rinjtë i shfrytëzojnë për tu informuar me vendimet e komunës, mediet prijnë bindshëm. Në Prizren 58 për qind të rinjve përdorin mediat për tu informuar me vendimet e komunës, derisa në Gjilan kjo përqindje është më e ulët apo 53 për qind. Megjithatë 27 për qind e të rinjve të anketuar të Gjilanit kanë theksuar se e përdorin ueb faqen e komunës si burim të informimit. Edhe mediat sociale figurojnë si mjete që përdoren për informim nga të rinjtë, por jo në masë të madhe.

## V. Përfundimet

Në bazë të dhënave zyrtare të regjistrimit të fundit të popullsisë, të rinjtë e moshës 15-27 vjeçare përbëjnë pothuajse një të katërtën e banorëve të Prizrenit dhe të Gjilanit. Nga 177,781 banorë të Prizrenit, 43, 288 i përkasin moshës 15-27 vjeçare. Ndërsa nga 90,178 banorë të Gjilanit, 22,230 i përkasin moshës 15-27 vjeçare.<sup>4</sup>

Në bazë të dhënave të dala nga hulumtimi mund të nxirret përfundimi se organet komunale kanë lënë anash apo kanë përjashtuar nga proceset vendimmarrëse një të katërtën e popullatës vitale.

Rezultatet e anketave po ashtu legjitimojnë të gjeturat dhe shqetësimet e ngritura tash e disa vjet mbi transparencën komunale nga monitoruesit e shoqërisë civile. Madje edhe

<sup>4</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Regjistrimi i Popullsisë 2011, në <http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore%20demografike%20sipas%20komunave.pdf>

epërsia e Gjilanit karshi Prizrenit sa i përket transparencës dhe përfshirjes së publikut ka qenë evidente në raportet e organizatave jo-qeveritare që janë marrë me studimin e këtyre çështjeve.

Komuna e Gjilanit gjatë tri viteve të fundit (2010-2012) ka përmirësuar nivelin e transparencës komunale. Ueb faqja zyrtare e Komunës posedon materiale dhe informata të shumëllojshme për shumicën e sferave që mbulon Komuna dhe po ashtu janë të publikuara edhe raportet financiare të këtij institucioni, si në lëminë e të hyrave ashtu edhe në atë të shpenzimeve të parasë publike<sup>5</sup>.

Ndërkaq Qeverisja lokale në Prizren vuan nga shumë të meta strukturore. Transparenca, si parim themelor i qeverisjes së mirë, pa dyshim se renditet në krye të kësaj liste. Për më tepër, ueb faqja e komunës përmban vetëm informacion protokollar, ndërsa aty postohen vetëm vendimet e marra në formën e tyre përfundimtare. Kjo praktikë është në kundërshtim me kërkesat e qeverisjes demokratike për krijimin e mundësive për pjesëmarrje dhe ndikim qytetar në marrjen e vendimeve edhe gjatë procesit të hartimit të politikave.<sup>6</sup>

Pavarësisht kësaj si komuna e Prizrenit ashtu edhe ajo e Gjilanit duhet të bëjnë përpjekje më të sigqerta për rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Ata duhet të zbatojnë dispozitat ligjore, të vëjnë në funksion mekanizma të ndryshëm institucional si dhe të bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe grupet

e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të llogaridhënies, transparencës dhe hartimit e shpenzimit adekuat të buxhetit komunal.

Duhet rikujtuar se transparenca dhe përfshirja në vendimmarrje nuk duhet të jenë çështje të diskutueshme, sepse ato përbëjnë hapin e parë drejt qeverisjes së mirë dhe efektive. Transparenca e duhur rreth vendimmarrjes sjell dobi si për komunitetin ashtu edhe për udhëheqësit komunal. Të qenit të informuar rreth projekteve komunale ndihmon qytetarët që të identifikohen dhe të lidhen me komunitetin. Një lidhje e tillë është jetike për qeverinë lokale që të funksionojë në mënyrë efektive dhe të marrë vendime në interes të publikut. Përveç kësaj, shpërndarja e informatave përbën një parakusht të rëndësishëm, për adresimin e prioritetëve të qytetarëve dhe hartimin e buxhetit racional. Koordinimi i duhur ndërmjet trekëndëshit, qytetar, komunë dhe Qeveri mundëson identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të qytetarëve por edhe shoshitjen e ideve në mënyrë që të hartohen projektet që i sjellin më shumë dobi komunitetit<sup>7</sup>.

<sup>5</sup> Instituti GAP, Letërnjoftimi i komunës së Gjilanit 2013, në [http://www.institutigap.org/documents/76619\\_LeternjoftimiGjilan2013.pdf](http://www.institutigap.org/documents/76619_LeternjoftimiGjilan2013.pdf)

<sup>6</sup> EC Ma Ndryshe, Transparenca lokale në Prizren, në [http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC\\_Transparenca\\_lokale\\_ne\\_Prizren.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_Transparenca_lokale_ne_Prizren.pdf)

<sup>7</sup> EC Ma Ndryshe, Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, në [http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC\\_Respektimi\\_i\\_ligjit\\_ne\\_qeverisjen\\_lokale.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_Respektimi_i_ligjit_ne_qeverisjen_lokale.pdf)

## VI. Rekomandimet

Me qëllim të përmirësimit të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje por edhe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, rekomandojmë që, komunat e Prizrenit dhe Gjilanit:

- Të tregojnë gatishmëri për ndryshimin e mënyrës së vendimmarrjes në nivel lokal;
- Të zbatojnë UA 2008/09 të MAPL-së dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi për rritjen e transparencës dhe të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje;
- Të krijojnë kushte për përfshirjen e qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit komunal;
- Të ofrojnë mbështetje për propozimet e dala nga konsultimet me grupet rinore;
- Të informojnë pjesëmarrësit e debateve publike mbi rezultatet dhe ndikimin e përfshirjes së tyre;

- Të aplikojnë metoda moderne për konsultim publik dhe pjesëmarrjen e publikut, duke vënë në përdorim edhe mediat sociale;
- Të zhvillojnë mjete efektive të komunikimit, veçanërisht përmes “medieve të reja” me qëllim të rritjes së nivelit të pjesëmarrjes aktive të rinjve nga grupe të ndryshme të komuniteteve;
- Të shqyrtojnë mundësitë e paraqitjes së vendimeve dhe informatave relevante në mediet sociale si pjesë e strategjisë së marrëdhënies me publikun;
- Të përdorin teknologjitë e mediave sociale për të angazhuar publikun në dialogun qeveri lokale-qytetar dhe për ofrimin mundësisë së diskutimit dhe zhvillimit të politikave si dhe zbatimit të tyre.
- Të kuptojnë rëndësinë dhe potencialin që kanë mediat sociale si hapësirë për komunikim dhe mobilizim;
- Të krijojnë dhe promovojnë Facebook faqet, llogaritë në Twitter, të shkruajnë bllogje, etj.

## EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale në Prizrenit për të krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

*Projektet kryesore:* Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit dhe Mamushës (2012 - 2013), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

*Publikimet:* “Prizreni qytet kulturor”, film dokumentar (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (pritet të publikohet në shtator 2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Katër analiza të projektit “Online Trasparency”: 1. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 2. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 3. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 4. Transparenca e qeverisjes lokale ne Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).



## Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Organizata Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC) është themeluar në vitin 2001 kurse është regjistruar më 8 janar të vitit 2002 me numrin 51011813. Në fillim, misioni i organizatës ka qenë që të krijojë paqe të qëndrueshme në Kosovë duke ndërlidhur të rinjtë e të gjitha komuniteteve të Kosovës në realizimin e projekteve të përbashkëta dhe në këtë mënyrë të tejkalojnë barrierat e krijuara nga e kaluara.

Nga vitin 2004, organizata ka transformuar misionin e saj. Kështu nga kjo periudhë, misioni i organizatës është të ngritë aktivizmin qytetar, forcojë ndjenjën e komunitetit dhe të promovojë qeverisje të përgjegjshme sikur edhe të mbështesë dhe zhvillojë iniciativat lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për zhvillimin e resurseve humane në Kosovë e në veçanti të rinisë Kosovare.

Në këtë mënyrë, caku kyç i projekteve të organizatës është rinia e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia nacionale, fetare, racore, etj. Në këtë mënyrë, organizata ka përcaktuar edhe programet e saj përmes së cilave synon të arrijë misionin:



- Demokratizimi i shoqërisë duke monitoruar/ avokuar institucionet qeverisëse,
- Edukimi jo formal i qytetarëve e në veçanti edukimi i të rinjve në fushën e krijimit të vendeve të reja të punës,
- Fuqizimi i Shoqërisë Civile dhe Rrjetëzimi me organizata të ngjashme me qëllim të realizimit të projekteve që tangojnë misionin e organizatës,
- Bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar.

Deri më tani organizata ka realizuar një numër të madhe të projekteve (mbi 40), si lidere e tyre por edhe si partnere e organizatave të tjera nga Kosova dhe organizatave ndërkombëtare dhe këto projekte, pothuajse në tërësi, janë financuar nga organizatat/ donatorët ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë dhe jashtë Kosove. Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC) vazhdon të jetë aktive duke realizuar projekte vetanake apo si partner i organizatave të tjera.



## **SHTOJCË**

# **Rezultatet me grafike për Prizren dhe Gjilan**



**A keni njohuri për mënyrën e funksionimit dhe vendimmarrjen në komunën tuaj?**





**Transparenca për qeverisjen në komunën tuaj**





**Informimi për vendimet e komunës**





**A i bën komuna publike vendimet dhe listën e shërbimeve që i ofron ?**





**Informimi lidhur me procedurat dhe dokumentet për aplikim në shërbimet që ofrohen në komunë**





**Inicimi i nismës për zgjidhjen e ndonjë problemi në komunë**





**Mbledhjet e Kuvendit Komunal**





**Debate publike të organizuara nga komuna**





**Informimi për procesin e hartimit të buxhetit të komunës**





**Aktivitete të ndërlidhura me hartimin e buxhetit komunal**





**Në çfarë shkalle janë bërë publike detajet nga përmbajtja e buxhetit komunal ?**





**Performanca buxhetore e komunës**





**Njohuritë mbi ekzekutimin e buxhetit të komunës**





**Qasja në vlerësimin dhe monitorimin e buxhetit komunal**





**Konsultimi i komunës me të rinjtë gjatë hartimit të dokumenteve strategjike**





**Paraqitja e problemeve të të rinjëve para kryetarit të komunës dhe drejtorët e drejtorive**



**Raportimi i shqetësimeve me administratën komunale**





**Zbatimi i masave nga komuna për inkurajimin e funksionimit aktiv të komuniteteve urbane**









**Instrumentet në dispozicion për të shprehur kënaqësinë apo pakënaqësinë me qeverisjen lokale**





**Mekanizmat a ankesës në dispozicion për raportim të sjelljes jo-profesionale të punonjësve të administratës komunale**



**Njohuritë e të rinjëve për të drejtat që ka komuna (drejtoria) ndaj tyre**



**Kënaqshmëria në ndarjen e buxhetit për drejtorinë e rinisë**

## Përgjigjet sipas gjinisë në Komunën e Gjilanit

1. A keni njohuri për mënyrën e funksionimit dhe vendimmarrjes në komunën tuaj?	<b>Po</b> 43.5 %		<b>Jo</b> 55 %		<b>Refuzoj</b> 1.5%									
	F 36%	M 51%	F 62%	M 48%	F 2%	M 1%								
2. Sipas mendimit tuaj sa është transparente qeverisja e komunës suaj?	<b>Shumë</b> 4%		<b>Mesatar</b> 46%		<b>Pak</b> 45%		<b>Nuk di / Refuzoj</b> 4.5%		<b>Nuk ka transparencë</b> 0.5%					
	F 4%	M 4%	F 49%	M 43%	F 40%	M 50%	F 7%	M 2%	F /	M 1%				
3. Cilat mekanizma i shfrytëzoni për t'u informuar me vendimet e komunës?	<b>Ueb Faqja e Komunës</b> 27%		<b>Tabela e Shpalljeve</b> 10%		<b>Mediet (TV Gazeta)</b> 53%		<b>Mediet Sociale</b> 5.5%		<b>Raportet</b> 1.5%		<b>Konferencat për shtyp</b> 1.5%		<b>Refuzoj</b> 2%	
	F 29%	M 25%	F 8%	M 12%	F 57%	M 49%	F 2%	M 9%	F 1%	M 2%	F 1%	M 1%	F 2%	M /
4. Komuna e juaj a i bën publike vendimet dhe listën e shërbimeve që i ofron?	<b>Po</b> 39.5%		<b>Jo</b> 36%		<b>Refuzoj</b> 24.5%									
	F 35%	M 44%	F 35%	M 37%	F 30%	M 19%								
5. Si informoheni në lidhje me procedurat dhe dokumentet për të aplikuar për shërbime që ofrohen?	<b>Personeli</b> 45.5%		<b>Tabela njoftuese</b> 24.5%		<b>Ueb faqja</b> 13.5%		<b>Mediet (TV, Gazeta) 12%</b>		<b>Mediet sociale</b> 3.5%		<b>Refuzoj</b> 1%			
	F 41%	M 50%	F 29%	M 20%	F 16%	M 11%	F 11%	M 13%	F 1%	M 6%	F 2%	M /		
6. A keni provuar personalisht apo në grup që të iniconi ndonjë nismë në komunën tuaj gjatë viteve të fundit?	<b>Po</b> 29.5%		<b>Jo</b> 68.5%		<b>Refuzoj</b> 2%									
	F 22%	M 37%	F 77%	M 60%	F 1%	M 3%								
7. A keni marrë pjesë në ndonjë mbledhje të Kuvendit Komunal?	<b>Po</b> 13%		<b>Jo</b> 83%		<b>Refuzoj</b> 4%									
	F 11%	M 15%	F 86%	M 80%	F 3%	M 5%								
8. A keni marrë pjesë në ndonjë debat publik të organizuar nga komuna?	<b>Po</b> 35.5%		<b>Jo</b> 63%		<b>Refuzoj</b> 1.5%									
	F 34%	M 37%	F 65%	M 61%	F 1%	M 2%								
9. A keni qenë të informuar për procesin e hartimit të buxhetit komunal?	<b>Po</b> 14%		<b>Jo</b> 82%		<b>Refuzoj</b> 4%									
	F 10%	M 18%	F 86%	M 76%	F 4%	M 4%								

10. Nëse po, a keni marrë pjesë në ndonjë aktivitet të ndërlidhur me hartimin e buxhetit komunal?	<b>Po 7%</b>		<b>Jo 75%</b>		<b>Refuzoj 18%</b>								
	F 6%	M 8%	F 74%	M 76%	F 20%	M 16%							
11. Në çfarë forme janë bërë publike detajet nga përmbajtja e buxhetit komunal?	<b>Shumë lartë 3%</b>		<b>Mesatare 34%</b>		<b>Ulët 42.5%</b>		<b>Shumë ulët 5.5%</b>		<b>Refuzoj 5%</b>				
	F 4%	M 2%	F 26%	M 42%	F 46%	M 39%	F 4%	M 7%	F 20%	M 20%			
12. Sa keni njohuri mbi performancën buxhetore të komunës?	<b>Shumë 3%</b>		<b>Mesatare 21%</b>		<b>Pak 64%</b>		<b>Aspak 7%</b>		<b>Refuzoj 6.5%</b>				
	F 1%	M 5%	F 19%	M 23%	F 65%	M 63%	F 9%	M 5%	F 6%	M 4%			
13. Sa keni njohuri mbi ekzekutimin e buxhetit të komunës?	<b>Shumë 3%</b>		<b>Mesatare 14.5%</b>		<b>Pak 68%</b>		<b>Aspak 8%</b>		<b>Refuzoj 6.5%</b>				
	F 2%	M 5%	F 11%	M 18%	F 65%	M 64%	F 9%	M 7%	F 6%	M 7%			
14. Sa keni qasje në vlerësimin e monitorimin e buxhetit komunal(raport vjetor financiar etj)?	<b>Shumë 4%</b>		<b>Mesatare 13.5%</b>		<b>Pak 62%</b>		<b>Aspak 13.5%</b>		<b>Refuzoj 7%</b>				
	F 3%	M 5%	F 12%	M 15%	F 58%	M 66%	F 17%	M 10%	F 10%	M 4%			
15. Në çfarë mënyre ju ka konsultuar komuna gjatë hartimit të dokumenteve të rëndësishme strategjike, planeve etj?	<b>Debate publike 29.9%</b>		<b>Ueb faqe 23.5%</b>		<b>Nuk na ka konsultuar 36.4%</b>		<b>Tjetër 4.8%</b>		<b>Refuzoj 5.3%</b>				
	F 26%	M 30%	F 26%	M 18%	F 33%	M 35%	F 4%	M 5%	F 6%	M 4%			
16. A keni pasur ndonjë mundësi që problemet aktuale t'i paraqitni para kryetarit të komunës dhe drejtorit të drejtorive?	<b>Po 13%</b>		<b>Jo 78%</b>		<b>Refuzoj 9%</b>								
	F 13%	M 13%	F 80%	M 76%	F 7%	M 11%							
17. A keni raportuar ndonjë shqetësim në administratën komunale?	<b>Po (është zgjidhur) 9.5%</b>		<b>Po (nuk është zgj.) 25.5%</b>		<b>Jo 65%</b>								
	F 7%	M 12%	F 22%	M 29%	F 71%	M 59%							
18. A mendoni se komuna zbaton masa për inkurajimin e funksionimit aktiv të komuniteteve urbane?	<b>Po 36.5%</b>		<b>Jo 42%</b>		<b>Refuzoj 21%</b>								
	F 38%	M 39%	F 40%	M 44%	F 22%	M 21%							

19. Cilat janë instrumentet që keni në dispozicion për të shprehur kënaqësinë apo pa kënaqësinë me qeverisjen lokale?	<b>Ueb Faqe</b> <b>23%</b>		<b>Anketa</b> <b>43%</b>		<b>Nuk ka instrumente</b> <b>6%</b>		<b>Mediet (TV gazeta)</b> <b>12%</b>		<b>Mediet sociale</b> <b>9.2%</b>		<b>Tjetër</b>		<b>Refuzoj</b> <b>23%</b>	
	F 25%	M 21%	F 45%	M 41%	F 4%	M 8%	F 12%	M 12%	F 6%	M 13%	F 3%	M 2%	F 5%	M 3%
20. Komuna juaj a ka vënë në dispozicion mekanizma të duhur të ankesës për të raportuar sjelljen jo-profesionale të punonjësve të administratës komunale?	<b>Po</b> <b>28%</b>		<b>Jo</b> <b>49%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>23%</b>									
	F 32%	M 24%	F 42%	M 56%	F 26%	M 20%								
21. A keni njohuri për të drejtat e juaja(rinisë) që ka komuna (drejtoria) ndaj jush?	<b>Po</b> <b>47%</b>		<b>Jo</b> <b>46.5%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>6.5%</b>									
	F 49%	M 45%	F 46%	M 47%	F 5%	M 8%								
22. Sa keni qenë të kënaqur me ndarjen e buxhetit për drejtorinë e Rinisë(aktivitetet rinore)?	<b>Shumë</b> <b>2.5%</b>		<b>Mesatare</b> <b>26.5%</b>		<b>Pak</b> <b>24.5%</b>		<b>Shumë pak</b> <b>38%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>8.5%</b>					
	F 3%	M 2%	F 30%	M 23%	F 24%	M 25%	F 35%	M 41%	F 8%	M 9%				
23. Cila ka qenë kënaqësia apo pa kënaqësia që e keni shprehur dhe në çfarë forme?	<b>Ueb faqe</b> <b>18.1%</b>		<b>Anketa</b> <b>47.7%</b>		<b>Mediet (TV, gazetat)</b> <b>10.9%</b>		<b>Mediet sociale</b> <b>15%</b>		<b>Kutia e ankesave</b> <b>8.3%</b>					
	F 21%	M 14%	F 47%	M 45%	F 9%	M 12%	F 11%	M 18%	F 7%	M 9%				

## Përgjigjet e ndara sipas gjinisë në Komunën e Prizrenit

1. A keni njohuri për mënyrën e funksionimit dhe vendimmarrjes në komunën tuaj?	<b>Po 38 %</b>		<b>Jo 61 %</b>		<b>Refuzoj 0.5%</b>					
	F 29.5%	M 46.7%	F 69.5%	M 53.3%	F 1.1%	M /				
2. Sipas mendimit tuaj sa është transparente qeverisja e komunës suaj?	<b>Shumë 1.5%</b>		<b>Mesatar 38.5%</b>		<b>Pak 51%</b>		<b>Refuzoj 9%</b>			
	F 1.1%	M 1.9%	F 41.1%	M 36.2%	F 46.3%	M 55.2%	F 11.6%	M 6.7%		
3. Cilat mekanizma i shfrytëzoni për t'u informuar me vendimet e komunës?	<b>Mediet 58.5%</b>		<b>Mediet sociale 14.5%</b>		<b>Tabelat e shpalljeve 7.5%</b>		<b>Raportet 2%</b>		<b>Refuzoj 10%</b>	
	F 52.4%	M 65.3%	F 13.3%	M 15.8%	F 5.3%	M 9.5%	F /	M 9.5%	F 4.2%	M 3.8%
4. Komuna e juaj a i bën publike vendimet dhe listën e shërbimeve që i ofron?	<b>Po 24%</b>		<b>Jo 26%</b>		<b>Refuzoj 50%</b>					
	F 25.3%	M 22.9%	F 20%	M 31.4%	F 54.7%	M 45.7%				
5. Si informoheni në lidhje me procedurat dhe dokumentet për ta aplikuar për shërbime që ofrohen?	<b>Personeli 48%</b>		<b>Mediat 22.5%</b>		<b>Tabela njoftuese 16%</b>		<b>Ueb faqe 11.5%</b>		<b>Mediat sociale 2%</b>	
	F 47.4%	M 48.6%	F 7.4%	M 16.2%	F 25.3%	M 19%	F 4.2%	M 6.7%	F 7.4%	M 5.7%
6. A keni provuar personalisht apo në grup që të iniconi ndonjë nismë në komunën tuaj gjatë viteve të fundit?	<b>Po 10.5%</b>		<b>Jo 84%</b>		<b>Refuzoj 5.5%</b>					
	F 5.3%	M 15.2%	F 88.4%	M 80%	F 6.3%	M 4.8%				
7. A keni marrë pjesë në ndonjë mbledhje të Kuvendit Komunal?	<b>Po 15.5%</b>		<b>Jo 84%</b>							
	F 12.6%	M 18.1%	F 87.4%	M 81%						
8. A keni marrë pjesë në ndonjë debat publik të organizuar nga komuna?	<b>Po 19%</b>		<b>Jo 78%</b>		<b>Refuzoj 3%</b>					
	F 12.6%	M 21%	F 87.4%	M 75.2%	F 2.1%	M 3.8%				
9. A keni qenë të informuar për procesin e hartimit të buxhetit komunal?	<b>Po 8.5%</b>		<b>Jo 87%</b>		<b>Refuzoj 4.5%</b>					
	F 3.32%	M 13.3%	F 90.5%	M 83.8%	F 6.3%	M 2.9%				

10. Nëse po, a keni marrë pjesë në ndonjë aktivitet të ndërlidhur me hartimin e buxhetit komunal?	<b>Po</b> <b>1.5%</b>		<b>Jo</b> <b>69.5%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>29%</b>					
	F 2.1%	M 1%	F 71.6%	M 67.6%	F 26.3%	M 31.4%				
11. Në çfarë shkalle janë bërë publike detajet nga përmbajtja e buxhetit komunal?	<b>Shumë e lartë</b> <b>2%</b>		<b>Mesatare</b> <b>27%</b>		<b>E ultë</b> <b>36.5%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>34%</b>			
	F 1.1%	M 2.9%	F 21.1%	M 33.3%	F 34.7%	M 38.1%	F 43.2%	M 25.7%		
12. Sa keni njohuri mbi performancën buxhetore të komunës?	<b>Shumë</b> <b>4%</b>		<b>Mesatare</b> <b>12%</b>		<b>Pak</b> <b>78%</b>		<b>Aspak</b> <b>0.5%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>5.5%</b>	
	F 1.1%	M 6.7%	F 13.7%	M 10.5%	F 77.9%	M 78.1%	F 1.1%	M /	F 6.3%	M 4.8%
13. Sa keni njohuri mbi ekzekutimin e buxhetit të komunës?	<b>Shumë</b> <b>1.5%</b>		<b>Mesatare</b> <b>15%</b>		<b>Pak</b> <b>76%</b>		<b>Aspak</b> <b>0.5%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>7%</b>	
	F /	M 2.9%	F 10.5%	M 19%	F 82.1%	M 70.5%	F 1.1%	M /	F 6.3%	M 7.6%
14. Sa keni qasje në vlerësimin e monitorimin e buxhetit komunal(raport vjetor financiar etj)?	<b>Shumë</b> <b>4%</b>		<b>Mesatare</b> <b>11%</b>		<b>Pak</b> <b>74.5%</b>		<b>Aspak</b> <b>1%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>9.5%</b>	
	F 2.1%	M 5.7%	F 8.4%	M 13.3%	F 76.8%	M 72.4%	F 2.1%	M /	F 10.5%	M 8.6%
15. Në çfarë mënyre ju ka konsultuar komuna gjatë hartimit të dokumenteve të rëndësishme strategjike, planeve etj?	<b>Debat publik</b> <b>21.5%</b>		<b>Nuk na kanë konsultuar</b> <b>54.5%</b>		<b>Ueb faqe</b> <b>19%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>5%</b>			
	F 21.1%	M 21.9%	F 61.1%	M 48.6%	F 13.7%	M 23.8%	F 1.1%	M 2.9%		
16. A keni pasur ndonjë mundësi që problemet aktuale t'i paraqitni para kryetarit të komunës dhe drejtorit të drejtorive?	<b>Po</b> <b>11.5%</b>		<b>Jo</b> <b>83.5%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>5%</b>					
	F 12.6%	M 10.5%	F 82.1%	M 84.8%	F 5.3%	M 4.8%				
17. A keni raportuar ndonjë shqetësim në administratën komunale?	<b>Po (është zgjidhur)</b> <b>8.5%</b>		<b>Po (nuk është zgjidhur)</b> <b>21%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>41%</b>					
	F 5.3%	M 11.4%	F 12.6%	M 28.6%	F 81.2%	M 60%				
18. A mendoni se komuna zbaton masa për inkurajimin e funksionimit aktiv të komuniteteve urbane?	<b>Po</b> <b>14.5%</b>		<b>Jo</b> <b>44.5%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>41%</b>					
	F 14.7%	M 14.3%	F 41.1%	M 47.6%	F 44.2%	M 38.1%				

19. Cilat janë instrumentet që keni në dispozicion për të shprehur kënaqësinë apo pa kënaqësinë me qeverisjen lokale?	<b>Anketa</b> <b>46%</b>		<b>Ueb faqja</b> <b>16%</b>		<b>Mediat</b> <b>15%</b>		<b>Mediat sociale</b> <b>10%</b>		<b>Nuk ka instrumente</b> <b>11%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>2%</b>	
	F 53.7%	M 39%	F 10.5%	M 21%	F 15.8%	M 14.3%	F 13.7%	M 6.7%	F 6.3%	M 15.2%	F /	M 3.8%
20. Komuna juaj a ka vënë në dispozicion mekanizma të duhur të ankesës për të raportuar sjelljen jo-profesionale të punonjësve të administratës komunale?	<b>Po</b> <b>12%</b>		<b>Jo</b> <b>46.5%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>41.5%</b>							
	F 6.3%	M 17.1%	F 47.4%	M 45.7%	F 46.3%	M 37.1%						
21. A keni njohuri për të drejtat e juaja(rinisë) që ka komuna (drejtoria) ndaj jush?	<b>Po</b> <b>46.5%</b>		<b>Jo</b> <b>42.5%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>11%</b>							
	F 46.3%	M 46.7%	F 42.1%	M 42.9%	F 11.6%	M 10.5%						
22. Sa keni qenë të kënaqur për ndarjen e buxhetit për drejtorinë e rinisë(aktivitetet rinore)?	<b>Shumë</b> <b>4%</b>		<b>Mesatare</b> <b>14%</b>		<b>Pak</b> <b>27%</b>		<b>Shumë pak</b> <b>34%</b>		<b>Refuzoj</b> <b>21%</b>			
	F 4.2%	M 3.8%	F 13.7%	M 14.3%	F 26.4%	M 25.7%	F 35.8%	M 32.4%	F 17.9%	M 23.8%		
23. Cila ka qenë kënaqësia apo pa kënaqësia që e keni shprehur dhe në çfarë forme?	<b>Ueb faqja</b> <b>12.4%</b>		<b>Anketa</b> <b>33.2%</b>		<b>Mediat</b> <b>16.1%</b>		<b>Mediat sociale</b> <b>16.6%</b>		<b>Kutia e ankesave</b> <b>21.8%</b>			
	F 1.1%	M 13.3%	F 12.6%	M 31.4%	F 2.1%	M 19%	F 2.4%	M 13.3%	F 1.1%	M 19%		